Shpërthim me tritol në një vilë në Sarandë, kush është pronari: Më parë ka punuar në IKMT

07:39 - 5 Dhjetor, 2022

Një sasi tritoli ka shpërthyer në murin rrethues të një banese në Sarandë.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 04:45 të mëngjesit të sotëm (5 dhjetor).

Shpërthimi ka ndodhur në banesën e shtetasit Lefter Lefteri i njohur ndryshe si Afez Kulla.

Lënda eksplozive e dyshuar si tritol ishte vendosur te porta jashtë e vilës.

Nga shpërthimi ka pasur vetëm dëme materiale ndërsa policia ndodhet në vendin e ngjarjes.

Në objektin ku u vendos eksplozivi jetonte familja prej 4 anëtarësh e 54-vjeçarit Lefteri, i cili më parë ka punuar në IKMT.

Ky i fundit rezulton ndërtues, ndërsa më parë ka qenë punonjës i administratës publike.

Muajt e fundit Lefteri është kallëzuar madje dhe shoqëruar në komisariat lidhur me një objekt në ndërtim e sipër në lagjen nr.1.

Nuk dihen ende motivet e ngjarjes.

/Abcnews.al/

*Kryesore | Aktualitet | Afez Kulla | Ikmt | Lefter Lefteri | Sarande | Shperthen Tritoli | Tritol | Vila

Të ngjashme

EMRAT/ Rrihet me sende të forta roja i spitalit në Sarandë, niset me urgjencë drejt Tiranës

IKMT aksion në bregdet, prish pishinën dhe ndërtime të tjera të Hotel "Kastrati Empire"

Ndërtimi në Dhërmi, IKMT kallëzon penalisht IMT Himarë, komisariatin dhe IKMT në Vlorë

Minute pas minute

14:44
Formacionet zyrtare Argjentinë-Francë: Messi kërcen "tangon...

14:35
Busquets "gjysmë" jashtë nga Barcelona, Inter Miami në pritje t...

14:33
VIDEO/ Çfarë po ndodh në kufi?! Serbët tentojnë të thyejnë...

14:30
Tre lodra të rrezikshme që duhet t'i mbani larg fëmijëve të vegjël

14:17
Zinedine Zidane: Të luash në finalen e Kupës së Botës është...

ARTIKULL JOETIK?

14:44 - 18 Dhjetor, 2022
Formacionet zyrtare Argjentinë-Francë: Messi kërcen "tangon e fundit"...

14:35 - 18 Dhjetor, 2022
Busquets "gjysmë" jashtë nga Barcelona, Inter Miami në pritje të veteranit

14:33 - 18 Dhjetor, 2022
VIDEO/ Çfarë po ndodh në kufi?! Serbët tentojnë të thyejnë kordonin e policis...

14:30 - 18 Dhjetor, 2022
Tre lodra të rrezikshme që duhet t'i mbani larg fëmijëve të vegjël

14:17 - 18 Dhjetor, 2022
Zinedine Zidane: Të luash në finalen e Kupës së Botës është një ëndërr...

14:14 - 18 Dhjetor, 2022
"Kosova është zemra e Serbisë", protestë në kufi në mbështetje të serbëve...

14:13 - 18 Dhjetor, 2022
Shënjoi historinë në Brazil, ndahet nga jeta shkrimtarja e njohur,...

14:00 - 18 Dhjetor, 2022
Franca do të marrë 40.2 milionë euro nga FIFA, nëse fiton Kupën e Botës

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

| "Cash" | Privacy | Kushtet e Përdorimit |

Harta e faqes

Aktualitet
Politikë
Rajon
Sport
Botë
Ekonomi
Emisione
Moti
English
Life
Plus

Copyright © 2022 ABC NEWS. All rights reserved.